



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
URDHRI I PSIKOLOGUT  
KËSHILLI KOMBTËAR



Blv. Gjergj Fishta, Ndërtesa nr. 26, kati II, Ap.9, Tiranë, email: sekretaria@urdhriipsikologut.al, Tel.: 0035544 51 1804

Nr. 4

Tiranëmë, 01.03.2017

VENDIM

Nr.4, datë 01.03.2017

Në mbështetje të ligjit 40/2016 “Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë”, bazuar në nenet 6.b) dhe 16.2.dh) të këtij ligji,

VENDOSI:

1. Të përcaktojë procedurën për hartimin dhe miratimin e Rregullores për Administrimin dhe Përditësimin e Regjistrit Themeltar të Urdhrit të Psikologut, si më poshtë:
  - Secili nga anëtarët e Këshillit Kombëtar ka të drejtën të paraqesë pranë Presidentit të Urdhrit, brenda 15 ditëve nga ky vendim, projekt-rregullore apo sygjerime, propozime dhe çështje, që duhet të trajtohen në këtë rregullore.
  - Presidenti i Urdhërit harton një përmbledhje të të gjithë projekt-rregulloreve, sygjerimeve, propozimeve dhe çështjeve të ngritura, dhe ua komunikon të gjithë anëtarëve të Këshillit, të paktën 5 ditë përpara mbledhjes së radhës së Këshillit Kombëtar.
  - Në mbledhjen e radhës, Këshilli Kombëtar, pasi shqyrton nen për nen të gjithë propozimet, miraton variantin përfundimtar të Rregullores për Administrimin dhe Përditësimin e Regjistrit Themeltar.

PRESIDENTE E URDHRI

Valbona TRESKA



SEKRETARE

Armira BABOÇI

